VENDIM
Nr.280, datë 28.4.2010

PËR NJË SHTESË FONDI PËR KOMISIONIN E PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.
10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit të Prokurimit Publik, në buxhetin e vitit 2010, në programin "Shërbimi i prokurimit publik", të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave (grupi 87) i shtohet fondi prej 29 405 000 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e pesë mijë) lekësh, përkatësisht, 21 405 000 (njëzet e një milionë e katërqind e pesë mijë) lekë për shpenzime korrente dhe 8 000 000 (tetë milionë) lekë për shpenzime kapitale.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha